

### **AMF organizon për herë të parë në Shqipëri “Forumin Global 2019” të IOPS-it**

#### **Vështrim mbi tregjet**

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shkurt 2018

#### **Zhvillime të tjera**

- Investitorë Kujdes: Ndaj aktivitetit të shoqërisë me emrin FXLider
- Zhvillohet konferenca me temë “Sigurimi motorik – Sfida e inovacionit”
- Zhvillohet konferenca mbi rritjen dhe zhvillimin e tregut të titujve

#### **Edukimi i Konsumatorit**

- Sigurimet dhe Pensionet nga një perspektivë e re: Një ndryshim i rëndësishëm

#### **Lajme Ndërkombëtare**

- Çeki
- Poloni
- Rumani

**Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin**

## AMF organizon për herë të parë në Shqipëri “Forum Global 2019” të IOPS-it



Organizimi i një forumi financiar të këtyre përmasave është një zhvillim shumë pozitiv për Shqipërinë, që deri tani ishte përfaqësuar në mbledhjet dhe takimet e Organizatës, por pa mundur të sjellë në Tiranë një aktivitetet kaq të rëndësishëm.



*Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve (IOPS)*

Shqipëria do të organizojë për herë të parë Forumin Global 2019 të Organizatës Ndërkombëtare të Rregullatorëve të Pensioneve (IOPS). Vendimi është marrë në mbledhjen e anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv të IOPS-it në 22 shkurt 2018 në Dublin, Irlandë dhe i është bërë i ditur zyrtarisht Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në fillim të këtij muaji.

Organizimi i një forumi financiar të këtyre përmasave është një zhvillim shumë pozitiv për Shqipërinë, që deri tani ishte përfaqësuar në mbledhjet dhe takimet e Organizatës, por pa mundur të sjellë në Tiranë një aktivitetet kaq të rëndësishëm. Në të parashikohet të marrin pjesë drejtues të lartë të institucioneve financiare dhe autoriteteve rregullatore nga 76 vendet anëtare të IOPS-it.

Forumi Global, i parashikuar të zhvillohet në Tiranë, në periudhën tetor/nëntor 2019, do të sjellë në kryeqytetin shqiptar ekspertët më të mirë nga industria e fondeve të pensioneve, institutet kërkimore, si edhe përfaqësues nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të specializuar në këtë fushë.

Në njoftimin zyrtar, Komiteti Ekzekutiv i IOPS-it i shpreh gjithashtu mirënjohjen dhe vlerësimin e thellë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për ridimensionimin e marrëdhënieve me të gjatë vitit të fundit.

Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve (IOPS) është krijuar në vitin 2004 për të përfaqësuar interesat e enteve rregullatore të pensioneve private. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është anëtar me të drejta të plota në IOPS që nga muaji dhjetor i vitit 2006.

Çdo vit, në periudhën e vjeshtës, organizohet në vende të ndryshme Forumi Global, ku diskutohet mbi zhvillimet e fundit dhe sfidat me të cilat përballen rregullatorët dhe industria e fondeve të pensioneve private vullnetare. Takimi i këtij viti është planifikuar të mbahet në datat 24-26 tetor 2018, në Pekin.

Gjatë këtij viti, me mbështetjen e Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), AMF do të organizojë në Tiranë në datat 20-21 shtator 2018, seminarin me temë “Mbikëqyrja me fokus rrezikun”, në të cilin do të marrin pjesë përfaqësues nga vendet anëtare të EIOPA-s dhe ekspertë të fushës.

Nga viti i kaluar e në vazhdim, Autoriteti ka qenë dhe mbetet shumë i angazhuar për të thelluar bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare, duke marrë përsipër një rol të ri proaktiv në aktivitetet e rëndësishme për tregjet financiare jobankare.

Gjatë këtij viti, me mbështetjen e Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), AMF do të organizojë në Tiranë në datat 20-21 shtator 2018, seminarin me temë “Mbikëqyrja me fokus rrezikun”, në të cilin do të marrin pjesë përfaqësues nga vendet anëtare të EIOPA-s dhe ekspertë të fushës.

Gjithashtu në fillim të muajit qershor, Shqipëria do të presë për herë të parë “Takimin e Pesëmbëdhjetë të Iniciativës për Mbikëqyrjen e Sigurimeve për vendet e Evropës Juglindore, Qendrore e Lindore”. Takimi synon forcimin e bashkëpunimit midis vendeve të rajonit në fushën e sigurimeve.

Aktivitete të tilla shërbejnë jo vetëm për të promovuar Shqipërinë, por edhe për të sjellë eksperiencat më të mira financiare botërore në vendin tonë, duke rritur njëkohësisht mundësitë për investime.

## **VËSHTRIM MBI TREGJET**

### **Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shkurt 2018**


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-shkurt 2018 kapën vlerën mbi 2,337 milionë lekë, ose 0.10% më pak se në janar-shkurt 2017. Gjatë kësaj periudhe, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 168,054 me një rritje prej 3.17% krahasuar me janar-shkurt 2017.

Tregu vazhdon të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 93.05% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 6.75% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.19%.

Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 38.38% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zunë 61.62% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-shkurt 2018, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 766 milionë lekë, ose 13.29% më pak se në janar-shkurt 2017.

### Struktura e Tregut të Sigurimeve për periudhën Janar-Shkurt 2018



Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 38.38% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zunë 61.62% të totalit të tregut.

## ZHVILLIME TË TJERA

### Investitorë Kujdes: Ndaj aktivitetit të shoqërisë me emrin FXLider

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) paralajmëron investitorët për rrezikun ndaj shërbimeve të shoqërisë që operon me emrin FXLider nëpërmjet adresës së internetit <https://www.fxlider.com>.

Mbështetur në Ligjin nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për Titujt” dhe Vendimin nr. 55, datë 30.03.2011 “Për njohjen e veprimtarisë së agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë”, një shoqëri brokerimi e huaj lejohet të ofrojë shërbimet e saj në vendin tonë, përmes një “agjenti” të themeluar si shoqëri brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, pas miratimit nga AMF.

FXLider që operon në adresën <https://www.fxlider.com> nuk është i licencuar nga Autoriteti për të operuar si agjent për të ofruar shërbime investimi në Republikën e Shqipërisë.

Për këtë arsye, AMF i bën thirrje investitorëve të bëjnë shumë kujdes përpara se të marrin një vendim në lidhje me pranimin e një oferte të kryer nëpërmjet telefonatave ose mjeteve të tjera të komunikimit për t'i nxitur ata të regjistrohen ose hapin llogari nëpërmjet faqes së internetit <https://www.fxlider.com>, pasi Autoriteti nuk monitoron ligjshmërinë e aktivitetit të FXLider dhe nuk mund të jetë në mbrojtjen e interesave të investitorëve, që investojnë në subjekte apo platforma të palicencuara.

Autoriteti tërheq vëmendjen se çdo komunikim, nëpërmjet telefonit, email-it, apo mjeteve të tjera, që përfaqëson një ftesë ose marketing për të investuar nëpërmjet <https://www.fxlider.com>, është i jashtëligjshëm dhe u lutet investitorëve të denoncojnë pranë Policisë së Shtetit apo organeve të tjera ligjzbatuese të Republikës së Shqipërisë, në rast se kontaktohen nga kjo shoqëri.

Lista e shoqërive të licencuara nga AMF për ofrimin e shërbimeve për investime mund të gjenden në faqen zyrtare të AMF-së në linkun e mëposhtëm: [http://amf.gov.al/tt\\_agjent.asp](http://amf.gov.al/tt_agjent.asp)

Autoriteti, njëkohësisht po komunikon me të gjitha institucionet e tjera ligjzbatuese për të ndaluar aktivitetin e kësaj shoqërie.

FXLider që operon në adresën <https://www.fxlider.com> nuk është i licencuar nga Autoriteti për të operuar si agjent për të ofruar shërbime investimi në Republikën e Shqipërisë.



## Zhvillohet konferenca me temë “Sigurimi motorik – Sfida e inovacionit”



Gjatë zhvillimit të konferencës

Organizata Ndërkombëtare e Medias XPRIMM zhvilloi në datë 16 mars Vjenë, Austri konferencën me temë: “Sigurimi motorik – Sfida e inovacionit”. Gjatë zhvillimit të kësaj konference u trajtuan tema të rëndësishme që lidhen me sfidat e inovacionit në sigurimin motorik për vendet e Evropës. Sfida e inovacionit ishte një mjedis i nivelit të lartë për shkëmbimin e njohurive të biznesit për çështjet thelbësore të industrisë së sigurimeve motorike, si dhe një pikë takimi për tendencat e fundit në inovacionin teknologjik.

Ndër temat e trajtuara, përmendim:

- Performanca e tregjeve të sigurimit në (SECEE) gjatë 2017, ku u trajtuan përfitueshmëria, si duhet të përshtaten siguruesit ndaj makinave të vjetra, marrëdhënia sfiduese midis transportuesit rrugor dhe siguruesit, etj;
- Statusin aktual dhe sfidat e ardhshme në sistemin e Kartonit Jeshil, ndikimi i vlerësuar i zhvillimeve të fundit teknologjike, përfitimet dhe sfidat në e-Call dhe sistemin e Kartonit Jeshil;
- Teknologjitë moderne dhe sistemi ligjor, në mbështetje të shërbimeve më të mira dhe efikasitetit operacional në aktivitetin e zgjidhjes së kërkesave, përdorimi i teknologjisë për krijimin e një partneriteti afatgjatë me klientët, etj.

Teknologjia është bërë pjesë e rëndësishme dhe thelbësore e biznesit të sigurimeve, veçanërisht sektori i sigurimeve motorike, i cili është duke u përballur me një nga valët më të fuqishme të ndryshimit në historinë e saj.

Ndërkohë që siguruesit gjithnjë e më shumë po përpiqen të përfitojnë nga zhvillimet teknologjike, duke përmirësuar cilësinë e përgjithshme të shërbimeve, uljen e kostos dhe maksimizimin e efikasitetit, ata gjithashtu duhet të përballen edhe me sfidat e natyrshme që sjellin risitë teknologjike.

Organizata  
Ndërkombëtare e Medias  
XPRIMM zhvilloi në datë  
16 mars Vjenë, Austri  
konferencën me temë:  
“Sigurimi motorik – Sfida e  
inovacionit”. Gjatë  
zhvillimit të kësaj  
konference u trajtuan  
tema të rëndësishme që  
lidhen me sfidat e  
inovacionit në sigurimin  
motorik për vendet e  
Evropës.

Përdorimi i inteligjencës artificiale në pajisjet e reja teknologjike, duhet të shoqërohet me një strategji të kujdesshme, duke pasur parasysh aspektin ligjor aktual.

Për vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore, kryesisht në tregjet në zhvillim, ishte trajtimi i sfidave teknologjike, ndërkohë që akoma ballafaqohen me çështjet tradicionale të segmentit të sigurimit motorik, gjë që çon drejt ulëta.

## Zhvillohet konferenca mbi rritjen dhe zhvillimin e tregut të titujve

Komisioni i Letrave me Vlerë i SHBA-së (*United States Securities & Exchange Commission, SEC*) zhvilloi në datat 11-22 mars, në Washington, SHBA, konferencën e 28-të vjetore me temë “Rritja dhe zhvillimi i tregut të titujve”.



Ndërtesa e U.S. Securities and Exchange Commission, SEC

Temat e trajtuara, të cilat u ndoqën me mjaft interes nga pjesëmarrësit, gjatë ditëve të zhvillimit të konferencës, ishin:

- Krijimi i një programi efektiv ekzaminimi;
- Krijimi i një programi efektiv zbatueshmërie;
- Krijimi i një programi efektiv të transparencës së kompanive;
- Qeverisja e korporatave;
- Siguria kibernetike, Fintech dhe Darkweb;

Komisioni i Letrave me Vlerë i SHBA-së (*United States Securities & Exchange Commission, SEC*) zhvilloi në datat 11-22 mars, në Washington, SHBA, konferencën e 28-të vjetore me temë “Rritja dhe zhvillimi i tregut të titujve”.

- Mbikëqyrja me bazë riskun;
- Monitorimi i tregut;
- Investigimi i mashtrimeve në lidhje me transparencën e kompanive të listuara në bursë;
- Edukimi i investitorit;
- Manipulimi i tregut dhe identifikimi i mashtrimit;
- Investigimi i shkeljeve të ndërmjetësve;
- Mbikëqyrja e bursave dhe organizatave vetërregullatore
- Financimi i sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- Bashkëpunimi me autoritetet në lidhje me forcimin e zbatueshmërisë;
- Zhvillimi i tregut, prezantuar nga Banka Botërore.

Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin përfaqësues të autoriteteve mbikëqyrëse të vendeve të botës.



## Sigurimet dhe Pensionet nga një perspektivë e re: Një ndryshim irëndësishëm

(vijon nga numri i kaluar)

**Gabriel Bernardino**

Kryetar Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale,  
EIOPA Konferenca e 7-të vjetore e EIOPA-s  
Frankfurt, 22 nëntor 2017

Programi i konferencës së këtij viti iu dedikua temës “Sigurimet dhe pensionet nga një perspektivë e re”. Duke pasqyruar zhvillimet e kohës, z. Gabriel Bernardino, Kryetar i Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale në fjalën e hapjes theksoi se “...jetojmë në epokën e “inteligjencës artificiale” ku shkenca kompjuterike zhvillon “agjentë inteligjentë”, që do të thotë se kemi pajisje që e perceptojnë mjedisin e saj dhe ndërmarrin veprime që maksimizojnë shanset e saj për sukses për disa qëllime. Pra, si qenie njerëzore, duhet të jemi të aftë të “rifreskojmë” idetë tona, të “rishikojmë” rrugën tonë dhe të perceptojmë mjedisin tonë në mënyrë që të ndërmarrim veprime që maksimizojnë mundësinë tonë për ndërtimin e një tregu të suksesshëm sigurimesh dhe pensionesh për të mirën e shoqërisë sonë dhe qytetarëve tanë”.

Në fjalën e tij z. Gabriel Bernardino preku katër tema që përfshijnë prioritetet kryesore strategjike të EIOPA-s.

(Marrë me shkurtime e redaktime – pjesa e katërt)



Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale, EIOPA

### Ruajtja e stabilitetit në një botë të pasigurt

Një nga mësimet e nxjerra nga kriza e fundit financiare është nevoja për të pasur mjete të përshtatshme për rigjenerim dhe zgjidhje, të cilat do t'u mundësojnë autoriteteve kombëtare të ndërhyjnë në institucione të dështuara dhe të zgjidhin dështimet në mënyrë efektive dhe të rregullt. Aktualisht, nuk ekziston një qasje e harmonizuar rigjenerimi dhe zgjidhjeje për siguresit në Bashkimin Evropian. Zgjidhjet specifike kombëtare do të rrisnin fragmentimin në tregun e brendshëm dhe do të krijonin vështirësi shtesë gjatë trajtimit të rasteve ndërkufitare. Për të reduktuar këtë risk, për të shmangur koston ekonomike të panevojshme që rrjedh nga proceset e pakoordinuara të vendimmarrjes ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe për të siguruar zgjidhje të rregullt, kërkohet veprimi evropian. Prandaj, në korrik, EIOPA botoi një Opinion që bën thirrje për një shkallë minimale të harmonizimit në fushën e rigjenerimit dhe zgjidhjes për siguresit, e përbërë nga katër shtylla qendrore:

Aktualisht, nuk ekziston një qasje e harmonizuar rigjenerimi dhe zgjidhjeje për siguresit në Bashkimin Evropian. Zgjidhjet specifike kombëtare do të rrisnin fragmentimin në tregun e brendshëm dhe do të krijonin vështirësi shtesë gjatë trajtimit të rasteve ndërkufitare.

Për të vlerësuar aftësinë ripërtëritëse të (ri)sigurimeve dhe sektorëve të fondeve të pensioneve ndaj zhvillime të pafavorshme të tregut, EIOPA do të vazhdojë të iniciojë dhe koordinojë provat e rezistencës (stress test) të rregullta në gjithë Bashkimin Evropian.

- Përgatitja dhe planifikimi;
- Ndërhyrja e hershme;
- Zgjidhja;
- Bashkëpunimi e koordinimi ndërkufitar.

Për më tepër, kjo kornizë duhet të përafrohet me *Solvency II* dhe të zbatohet në mënyrë proporcionale.

Edhe pse prezantimi i *Solvency II* dhe, në veçanti, miratimi i kërkesave për kapital sipas regjimit të bazuar në rrezik dhe mbikëqyrja progresive duhet të kontribuojnë për të zvogëluar gjasat e dështimeve të sigurimeve, është e rëndësishme të kuptohet se *Solvency II* nuk është një regjim ku dështimi është zero dhe dështimet do të vazhdojnë të ndodhin. Përtej regjimeve të rigjenerimit dhe zgjidhjes, skemat e garancive të sigurimit mund të kontribuojnë në rritjen e mbrojtjes së përgjithshme të të siguruarve dhe përfituesve. Megjithatë, në Bashkimin Evropian kjo fushë është ende mjaft e fragmentarizuar, ku skemat ekzistuese dallojnë në mënyrë thelbësore në aspektin e financimit, funksioneve, mandatit dhe mbulimit. Ky fragmentim krijon probleme të veçanta në rastet e dështimeve që lidhen me biznesin ndërkufitar.

Besoj se në periudhën afatmesme është thelbësore, si për mbrojtjen e konsumatorit, ashtu edhe për funksionimin e duhur të tregut të brendshëm, të ndërtohet një qasje minimale e harmonizuar ndaj skemave kombëtare të garancisë së sigurimeve në Bashkimin Evropian. Siç tregohet në Rregulloren e saj, EIOPA do të fillojë të vlerësojë nevojën për një kornizë të tillë dhe synon të botojë një dokument diskutimi gjatë vitit 2018.

Për të vlerësuar aftësinë ripërtëritëse të (ri)sigurimeve dhe sektorëve të fondeve të pensioneve ndaj zhvillime të pafavorshme të tregut, EIOPA do të vazhdojë të iniciojë dhe koordinojë provat e rezistencës (*stress test*) të rregullta në gjithë Bashkimin Evropian. Në fund të vitit, EIOPA do të publikojë rezultatet e provave të rezistencës (*stress test*) të pensioneve profesionale të vitit 2017.

Një sistem financiar i qëndrueshëm mbështetet tek ne për të qëndruar vigjilent ndaj zhvillimeve të reja. Për shembull, përsa i përket vendimit të Mbretërisë së Bashkuar për t'u tërhequr nga BE, EIOPA botoi një opinion për të mbështetur autoritetet mbikëqyrëse kombëtare për të siguruar praktika të konsoliduara dhe konvergjente të lidhura me zhvendosjen e ndërmarrjeve në Mbretërinë e Bashkuar në BE27. Mbikëqyrja e konsoliduar kërkon vendndodhje të duhur të menaxhimit dhe funksioneve kryesore. EIOPA do të monitorojë zbatimin e atyre parimeve nga Autoritetet Kompetente Kombëtare (NCA) në procese konkrete autorizimi.

Reformat rregullatore pas krizës u hartuan me qëllimin e ndërtimit të tregjeve financiare më të qëndrueshme, të drejta e transparente dhe me lojtarë të udhëhequr më fuqishëm dhe më mirë.

Parë nga perspektivë e *Solvency II*, besoj se tani është më se e rëndësishme që të gjitha grupet e sigurimeve të vlerësojnë si duhet rreziqet e një skenari “cliff edge” (një situatë në të cilën një rritje e vogël e të ardhurave sjell një rritje të madhe të humbjeve) për biznesin e tyre dhe të marrin në konsideratë të gjitha zgjidhjet e mundshme për t’i zbutur ato sipas kuadrit rregullator në dispozicion. Autoritetet Kompetente Kombëtare duhet të inkurajojnë planifikimin e duhur të emergjencave nga grupet dhe të jenë të përgatitur për t’i rishikuar ato dhe për të marrë vendime.

### **Në përfundim,**

Reformat rregullatore pas krizës u hartuan me qëllimin e ndërtimit të tregjeve financiare më të qëndrueshme, të drejta e transparente dhe me lojtarë të udhëhequr më fuqishëm dhe më mirë. Tani është koha për të përfituar nga këto reforma dhe për të siguruar që institucionet financiare luajnë një rol në zgjidhjen e ngërçeve në zhvillimin shoqëror siç janë kursimet afatgjata dhe mangësitë në mbrojtjen nga katastrofat natyrore.

Është i domosdoshëm zhvillimi i zgjidhjeve inteligjente për këto boshllëqe dhe të gjithë duhet të japim kontributin tonë. Kohët e fundit, një futurist i njohur tha: “Ai për të cilin duhet të jemi më të shqetësuar nuk është domosdoshmërisht ndryshimi eksponencial në inteligjencën artificiale apo në robotikë, por reagimi i pandryshueshëm në inteligjencën njerëzore”.

Në EIOPA, ne do të vazhdojmë të promovojmë interesin e përbashkët publik që shtrihet përtej kufijve gjeografikë dhe dallimeve kulturore, duke forcuar konvergencën mbikëqyrëse në mënyrë që të përmbushim mandatin tonë për mbrojtjen e të siguruarve dhe stabilitetin financiar në Bashkimin Evropian.

## Çeki

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Në bazë të statistikave të publikuara nga Banka Qendrore e Republikës Çeke, tregu i sigurimeve gjeneroi 150.83 miliardë koruna CZK, monedha lokale (rreth 5.9 miliardë euro), me një rritje vjetore prej 2.5%. Sigurimi i Jetës pësoi rënie me 3.3%, ndërkohë që pjesa më e madhe sigurimit të Jo-Jetës shënoi rritje me 6.4%. Rritje me 1.15% shënuan edhe dëmet e paguara për një total prej 96.8 miliardë koruna (rreth 3.78 miliardë euro), pjesa më e madhe i përket sigurimit të Jo-Jetës, kryesisht për shkak të motit të keq që goditi vendin në gjysmën e dytë të vitit të kaluar.

## Poloni

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Siguruesit polakë e mbyllën vitin 2017 me fitime neto prej 5.7 miliardë zlota, PLN monedha vendase (ose 1.37 miliardë euro). 2.3 miliardë zlota erdhën nga sigurimi i Jetës dhe 3.4 miliardë nga sigurimi i Jo-Jetës. Në total, tregu gjeneroi 62.35 miliardë zlota të ardhura, (ose 14.94 miliardë euro), me një rritje vjetore prej 11.33%. Sigurimi i Jetës zë 40% të tregut, duke humbur gjithsesi peshën e tij nga viti në vit. Në vitin 2017, siguruesit polakë paguan 39.8 miliardë zlota (rreth 9.56 miliardë euro) dëme ndaj palëve të treta ose klientëve, me një rritje prej 8.6% në krahasim me një vit më parë.

## Rumani

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Tregu i sigurimeve në Rumani vijoi trendin rritës edhe në vitin 2017, duke gjeneruar 9.7 miliardë lei (RON, monedha lokale) ose 2.1 miliardë euro, me një rritje vjetore prej 3.5%. Sigurimi i Jo-Jetës mbetet dominues, me 7.7 miliardë lei (1.67 miliardë euro) të ardhura, edhe pse me një rënie prej 0.3%. Sa i përket sigurimit të Jetës, ai shënoi rritje me 21% në vitin 2017, duke i sjellë industrisë të ardhura prej 2 miliardë lei.



---

**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)